

AKT - THEMELIMI

I SHOQËRISË TREGTARE "UP GROUP" SHPK.

Në bazë të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", me vullnetin tonë te lirë, ne,

1. Gerson **TAFA**, shtetas shiptar, lindur në Tiranë më 22.04.1989, banues në Tiranë, me numer karte identiteti I90422085F.
2. Endri **NOTI**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 15.04.1987, banues në Tiranë, me numur karte identiteti I70415080U.

NENI 1

Formohet shoqëria tregtare e emërtuar "UP GROUP" shpk me ortakë themelues zotrinjtë: Gerson TAFA dhe Endri NOTI.

NENI 2

Shoqëria do të ketë statusin e një shoqërie me përgjegjesi të kufizuar dhe do të përballojë humbje deri në kufirin e kontributit të themeluesve të saj në kapitalin e regjistruar.

NENI 3

Shoqëria e ka selinë e saj në qytetin e Tiranës, rruga Dervish Bej Mitrovica, Tirana 1060, Nr.20. Ajo mund të çelë dhe seli të tjera të dyta, degë e filiale, përfaqesi e agjensi operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe me miratim të organeve kompetente edhe jashtë vendit.

NENI 4

Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj me një afat të pacaktuar.

NENI 5

Objekti i veprimtarisë do të jetë:

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është si vijon:

Në fushën e Menaxhimit dhe Marketingut:

- Konsulencë dhe trajnime profesionale për kompani të ndryshme
- Konsulencë dhe trajnime, marketingu për zhvillimin e biznesit dhe përthithjen e klientëve;

Konsulencë dhe trajnim në menaxhimin e kompanive për zhvillimin dhe zgjerimin e tyre; - Konsulencë dhe trajnim profesional për biznesin në bashkëpunim me zyra ligjore ndërkombëtare; Konsulencë dhe trajnim profesional për biznesin në bashkëpunim me zyrat fiskale ndërkombëtare.

Në fushën e Menaxhimit dhe Reklamimit:

Konsulencë dhe trajnim, marketingu për imazh profesional për biznesin; Konsulentcë dhe trajnim për reklamim për zhvillimin e imazhit profesional; Zhvillim, trajnim dhe krijim, prodhim dhe realizimin e çdo forme të reklamimit, digjitalë, web, në letër, etj. - Në fushën e produksionit televiziv, muzikë, kinema, reklama, botim, evente: - Konsulencë dhe trajnim për zhvillimin e placement të kompanisë dhe/ ose profesionale; - Krijimi dhe shitja e skenareve apo teksteve në lidhje me fushën e spektakleve; - Trajnime në fushën e televizionit, kinematografisë dhe web; - Prodhime dhe shpërndarje e filmave me metrazh të shkurtër,

filmave me metrazh të mesëm dhe filmave me metrazh të gjatë për kinematë; - Prodhimi dhe shpërndarja e filmave me metrazh të shkurtër, me metrazh të mesëm dhe atyre me metrazh të gjatë dhe digjitale, satelitore dhe/ose për reklamim të çfarëdo lloji forme; prodhimi dhe shpërndarja e muzikës digjitale, live, në dyqane dhe në të gjitha format e shitjeve.

- Prodhimi dhe shpërndarja e librave, revistave, fletushkave, etj., në format letre dhe/ose digjitale; Krijimi dhe realizimi i eventeve për individë dhe ente publike.

Në fushën e Turizmit:

Aktivitete të promovimit dhe trajnimit në fushën e turizmit në çfarëdo lloji forme dhe mjete;

- Aktivitete të realizimit të objekteve turistike në çfarëdo lloji forme dhe mjete; - Aktivitete të ndërmjetimit dhe të trajnimit në fushën e turizmit; Aktivitete të bashkëpunimit, konsulencës, Trajnimit, me struktura turistike publike dhe private; Aktivitete bashkëpunimi, konsulencë dhe trajnimi me organe publike dhe private.

Në fushën e Biznesit

Aktivitete krijimi, Trajnime, dhe zhvillimi të mundësive të reja të biznesit midis Shqiperisë dhe shteteve të tjera me vëmendje të veçantë në fushën territoriale dhe eksportimin e të mirave materiale, shërbimeve, lëndëve të para, etj.

- Aktivitete krijimi, trajnime dhe krijime të aktiviteteve që kontribuojnë në zhvillimin e investimeve, si dhe punësimin në Shqipëri nga investitorë kombëtarë dhe të huaj. Gjithashtu mund të ushtrojë çfarëdo lloji aktiviteti plotësues të ngjashëm apo të lidhur si më sipër parashikuar. Shoqëria me qëllimin për të promovuar, imazhin e saj në të gjithë territorin kombëtar, dhe jashtë saj, mund të ndërmarrë të gjitha iniciativat të cilat janë të përshtatshme për qëllimin e regjistrimit të markave apo të patentave. Kurse formimi dhe azhurnimi profesional. Krijimit, shpërndarjen dhe shitjen e librave, revistave apo të ngjashëm në sektorët e lartpërmendura.

- Shoqëria mund të bashkëpunojë dhe të marrë direkt ose indirekt interesa, në shoqëri, firma, agjensi dhe ndërmarrje të tjera, të cilat mund të kenë edhe qëllime të tjera aktiviteti. Gjithashtu, për të realizuar objektin dhe qëllimet e saj, shoqëria mund të ndërmarrë dhe zhvillojë çdo lloji aktiviteti lidhur me shitblerjen e pasurisë së luajtshme e të paluajtshme, si edhe çdo aktivitet tregtar, financiar, qiradhënës apo dorëzënës, që i vlerëson të dobishme apo të nevojshme për arritjen e qëllimeve të saj.

NENI 6

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njëqindmijë) lek dhe përbëhet nga 2(dy) kuota të barabarta dhe që do të zotërohen nga ortakët e shoqërisë si më poshtë:

- Gerson **Tafa** 1(një) kuotë = 50.000 lek ose 50% e kapitalit.
- Endri **NOTI** 1(një) kuotë = 50.000 lekë ose 50% e kapitalit


Ndryshimi i kuotave bëhet nëpërmjet kontributeve në kapital ose me shitblerje.

NENI 7

Kapitali i shoqërisë mund të shtohet ose të pakësohet sipas vendimeve të ortakëve, por asnjëherë nuk mund të pakësohet nën nivelin e kapitalit themeltar që përcakton ligji.

NENI 8

Ortakët mund t'u shesin të tretëve kuotat e tij të kapitalit pjesërisht ose tërësisht. Shitja e kuotave tek të tretet, do të bëhet vetëm pasi të ketë marrë vendim asambleja e ortakëve me 100% të votave.



2

NENI 9

Shoqëria ka vulën e saj.

NENI 10

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë:

- Asambleja e ortakëve.
- Administratori

Fusha e veprimit, përbërja dhe mënyra e funksionimit të organeve drejtuese rregullohet në statut.

NENI 11

Administrator i shoqërisë "UP GROUP" shpk emrohet z. Dorian **BOJA**, me afat 5 vjet, nga dita e regjistrimit të shoqërisë në QKB.

NENI 12

Transferimi i mjeteve monetare dhe transaksioneve financiare do të kryhen në baze të kriterëve të caktuar nga Banka e Shqipërisë. Shoqëria ka llogarinet e saj rrjedhese, si dhe librin e saj të llogarive në baze të kërkesave të ligjit 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

NENI 13

Fitimi neto i realizuar nga shoqëria mbetet në përdorim të ortakëve në masën 50% secili, mbasi të jenë likuiduar të gjitha detyrimet.

NENI 14

Ky akt u perpilua në prani të ortakëve duke shprehur vullnetin e tyre të plote e të lire. Akti u perpilua në katër kopje me fuqi të barabartë secila, për t'u depozituar në Qendren Kombëtare të Regjistrimit, Tiranë e për t'u shpërndarë në organet kompetente dhe një kopje mbetet në dokumentacionin e shoqërisë.

ORTAKET THEMELUES

Gerson TAFA

Endri NOTI

ENDRI NOTI

Tiranë, më 22.01.2024

STATUTI

I

SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“UP GROUP” shpk

Kapitulli I

EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA

Neni 1 – Forma

Forma juridike

- 1.1. Ne mbeshtetje te vendimit te asamblese se Ortakeve te shoqerise, ne pajtim te plote me dispozitat e Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” si dhe ligjit 9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, themelohet shoqeria tregtare “UP GROUP”shpk, e cila do te funksionoje sipas dispozitave te ligjit dhe neneve te ketij statuti.
- 1.2. Shoqëria “UP GROUP”shpk është krijuar me mjetet ne pronesi te themeluesve te saj,
 1. Gerson **TAFA**, shtetas shiptar, lindur në Tiranë më 22.04.1989, banues në Tiranë, me numer karte identiteti I90422085F.
 2. Endri **NOTI**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 15.04.1987, banues në Tiranë, me numur karte identiteti I70415080U.
- 1.3 Shoqëria “UP GROUP”shpk është themeluar në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, dhe aktiviteti i saj rregullohet me anë të këtij Statuti.
- 1.4 Shoqëria funksionon sipas ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare”.
- 1.5 Shoqëria ka vulën dhe logon e saj zyrtare.

Neni 2 – Emri

- 2.1 Emri i Shoqërisë është **“UP GROUP”** shpk.

Neni 3 – Objekti

- 3.1. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është si vijon:

Në fushën e Menaxhimit dhe Marketingut:

- Konsulencë dhe trajnime profesionale për kompani të ndryshme.
- Konsulencë dhe trajnime, marketing për zhvillimin e biznesit dhe përthithjen e klientëve;
- Konsulencë dhe trajnim në menaxhimin e kompanive për zhvillimin dhe zgjerimin e tyre;
- Konsulencë dhe trajnim profesional për biznesin në bashkëpunim me zyra ligjore ndërkombëtare; Konsulencë dhe trajnim profesional për biznesin në bashkëpunim me zyrat fiskale ndërkombëtare.

Në fushën e Menaxhimit dhe Reklamimit:

- Konsulencë dhe trajnim, marketing për imazh profesional dhe/ose për biznesin; konsulencë dhe trajnim për reklamime për zhvillimin e imazhit të biznesit dhe/ose profesional;
- Zhvillim, trajnim dhe krijim, prodhim dhe realizimin e çdo forme te reklamimit, digjitalë, Ueb, në letër, etj.

Në fushën e produksionit televiziv, muzikë, kinema, reklama, botime, evente:

- Konsulencë dhe Trajnim per zhvillimin e product placement të kompanisë dhe/ose profesionale;
- Krijimi dhe shitja e skenareve apo teksteve ne lidhje me fushën e spektakleve; trajnime në fushen e televizionit, kinematografise dhe eb;
- Prodhime dhe shperndarje e filmave me metrazh te shkurter, filmave me metrazh te mesëm dhe filmave me metrazh te gjate per Kinemate;
- Prodhimi dhe shperndarja e filmave me metrazh te shkurter, me metrazh te mesem dhe atyre me metrazh te gjate dhe Tv dixhitale, satelitore dhe/ose per reklamim te ç'farëdo lloj forme;
- Prodhimi dhe shperndarja e muzikës dixhitale, live, në dyqane dhe në të gjitha format e shitjeve;
- Prodhimi dhe shpërndarja e librave, revistave, fletushkave, etj., në format letre dhe/ose dixhitale;
- Krijimi dhe realizimi i eventeve per individë dhe ente publike.

Në fushën e Turizmit:

- Aktivitete të promovimit dhe trajnimit në fushen e turizmit ne çfardo lloj forme dhe mjeti;
- Aktivitete të realizimit të objekteve turistike në çfaredo lloj forme dhe mjeti;
 - Aktivitete të ndërmjetësimit dhe të trajnimit në fushën e turizmit;
 - Aktivitete të bashkepunimit, konsulencës, trajnimit, me struktura turistike publike dhe private;
 - Aktivitete bashkepunimi, konsulence dhe trajnimi me organe publike dhe private. 2

Në fushen e Biznesit:

- Aktivitete krijimi, trajnime, dhe zhvillimi te mundësive te reja te biznesit midis Shqiperise dhe shteteve te tjera me vëmendje të veçantë në fushën territoriale dhe eksportimin e të mirave materiale, shërbimeve, lëndëve te para, etj.
- Aktivitete krijimi, trajnime dhe krijime të aktiviteteve që kontribuojnë ne zhvillimin e investimeve, si dhe punësimin në Shqipëri nga investitorë kombëtarë dhe të huaj. Gjithashtu mund të ushtrojë çfardolloy aktiviteti plotësues, aksesorë, të ngjashëm apo të lidhur si më sipër parashikuar.
- Shoqëria edhe më qëllimin për të promovuar, imazhin e saj ne te gjithë territorin kombëtar, dhe jashtë saj, mund të ndërmarrë të gjitha iniciativat të cilat janë të përshtatshme për qëllimin, dhe që janë: regjistrimin e markave apo të patentave; kurse formimi dhe axhornimi profesional; krijimit, botimit, përhapjes, shpërndarjes dhe shitjes se librave, revistave apo te ngjashëm ne sektorët e lartpërmendura; ekspozitave manifestimet në përgjithësi, edhe duke bashkëpunuar për këtë gjë me organizatat e kategorisë të pranishme në të gjithë territorin.
- Shoqëria mund të bashkëpunojë dhe/ose të marrë direkt ose indirekt interesa, në shoqëri, firma, agjensi dhe ndërmarrje të tjera, të cilat mund të kenë edhe qëllime të tjera aktiviteti. Gjithashtu, për të realizuar objektin dhe qëllimet e saj, shoqëria mund të ndërmarrë dhe zhvillojë çdo lloj aktiviteti lidhur me shitblerjen e pasurisë së luajtshme e të paluajtshme, si edhe çdo aktivitet tregtar, financiar, qiradhënës apo dorëzënës, që i vlerëson të dobishme apo të nevojshme për arritjen e qëllimeve të saj.

Neni 4 – Selia

- 4.1. Selia zyrtare e shoqërisë ndodhet në adresën: rruga Dervish Bej Mitrovica, Tirana 1060, Nr.23.
- 4.2. Asambleja e përgjithshme mund të vendosë të transferojë selinë e shoqërisë në një vend tjetër, apo mund të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë kudo, brënda apo jashtë Republikës së Shqipërisë.



5

Neni 5 – Kohëzgjatja

- 5.1. Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë do të jetë pa kufizim.
- 5.2. Shoqëria mund të përfundojë apo vihet në likuidim përpara këtij afati me vendim të asamblesë së përgjithshme.

Neni 6 – Përgjegjësitë

- 6.1. Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e marra për qëllime që nuk përputhen me ato të përcaktuara nga Statuti.
- 6.2. Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e marra nga ortakët në emrin e tyre personal ndaj personave të tretë.

Kapitulli II

KAPITALI I SHOQERISE

Neni 7 – Kapitali

- 7.1 Kapitali i nënshkruar i shoqërisë do të jetë 100.000 lek.

Neni 8 – Kuotat e kapitalit dhe zotërimi i tyre

- 8.1. Kapitali është i përbërë nga 2 (dy) kuota dhe zotrohen në mënyrë të barabartë nga të dy ortakët nga 1(një) kuotë secili.
- 8.2. Kuotat e kapitalit të Shoqërisë zotërohen nga ortakët si më poshtë:
 - Gerson **Tafa** zotëron 1(një) kuotë = me 50% e kapitalit.
 - Endri **NOTI** zotëron 1(një) kuotë = me 50% e kapitalit.

Neni 9 – Zmadhimi i kapitalit

- 9.1. Asambleja e përgjithshme mund të rrisë pa kufi kapitalin e Shoqërisë.
- 9.2. Rritja e kapitalit mund të bëhet nëpërmjet financimit të ortakëve ose nëpërmjet përfshirjes në kapital të fitimeve dhe rezervave të shoqërisë.
- 9.3. Administratorët njoftojnë për regjistrim, pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të vendimit për zmadhimin e kapitalit. Vendimi publikohet edhe në faqen e internetit të shoqërisë.
- 9.4. Zmadhimi i kapitalit bëhet efektiv në datën e regjistrimit të realizimit të tij, në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- 9.5. Pas miratimit të pasqyrave financiare të vitit paraardhës, asambleja e përgjithshme vendos edhe për fitimet e realizuara. Asambleja mund të vendosë që me këto fitime të zmadhojë kapitalin e regjistruar, të rrisi rezervat statutorë ose të shpërndajë dividend.



- 9.6. Në asnjë rast nuk mund të rritet kapitali i shoqërisë pa mbuluar më parë humbjet e rezultuara në pasqyrat financiare.
- 9.7. Në përputhje me nenin 77 të ligjit 9901 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare”, përpara se të vendoset për shpërndarje dividenti, administratorët lëshojnë çertifikatë të aftësisë pagueuse. Kjo çertifikatë lëshohet vetëm nëse pas pagimit të dividendit, aktivet e shoqërisë i mbulojnë tërësisht detyrimet e saj dhe shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

Neni 10 – Krijimi i rezervave

- 10.1 Mbas miratimit të pasqyrave financiare, asamblea krijon rezerva statutore. Rezerva statutore mund të jetë për çdo vit deri në 10% e fitimit vjetor. Kur këto rezerva të kapin shumën sa 10% të kapitalit themeltar, atëhere asamblea e ortakëve mund të mos krijojë më rezerva.

Neni 11 – Zvogëlimi i kapitalit të regjistruar

- 11.1. Asambleja e përgjithshme mund të reduktojë kapitalin e regjistruar. Në çdo rast kapitali i regjistruar nuk mund të reduktohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji (njëqind lek).
- 11.2. Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim, nga administratorët. Ky vendim publikohet edhe në faqen e internetit të shoqërisë.

Neni 12 – Transferimi i kuotave të kapitalit dhe e drejta e parablerjes

- 12.1. Kuotat e kapitalit mund t’u transferohen të tretëve tërësisht ose pjesërisht, vetëm me vendim të asamblesë së përgjithshme.
- 12.2. Transferimi për çfarëdo arsyeje, tërësisht ose pjesërisht i kuotave të kapitalit të shoqërisë është subjekt i të drejtës së parablerjes, në favor të ortakëve të tjerë, të cilët mund të ushtrojnë këtë të drejtë, brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga marrja e njoftimit të dërguar me letër rekomande, i cili përmban ofertën. Në rast se ortakët e tjerë nuk përgjigjen brenda afatit të parashikuar, konsiderohet se kanë hequr dorë prej të drejtës së parablerjes.
- 12.3. Në rast se njëri prej ortakëve refuzon apo heq dorë nga ushtrimi i të drejtës së tij të parablerjes, ortakët e tjerë, të cilët tashmë kanë ushtruar të drejtën e tyre të parablerjes, mund ta ripërdorin këtë të drejtë edhe për pjesën e ofruar ortakut që e refuzoi atë.
- 12.4. Në rast se më shumë se një ortak dëshirojnë të ripërdorin të drejtën e parablerjes, kuotat e kapitalit të ofruara ortakut që nuk dëshironte ta ushtronte të drejtën e tij, ndahen në proporcion me pjesët e kapitalit respektiv.
- 12.5. Në rast se vetëm njëri prej ortakëve dëshiron ta ushtrojë të drejtën e parablerjes, kuotat e kapitalit të ofruar i transferohet atij tërësisht ose në atë masë që ky ortak dëshiron.



- 12.6. Ortakët që dëshirojnë të ripërdorin të drejtën e tyre të parablerjes duhet t'i njoftojnë vendimin e tyre ortakut që dëshiron të transferojë kuotat e tij të kapitalit brënda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, që prej marrjes së lajmit për mos ushtrimin e së drejtës së parablerjes prej ndonjërit prej ortakëve.
- 12.7. Të gjitha njoftimet e sipërpërmendura do të bëhen me shkrim dhe i adresohen administratorit të Shoqërisë.

Neni 13 - Pasojat e kalimit të kuotave

- 13.1 Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj Shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit.

Kapitulli III

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME, ADMINISTRIMI, KONTROLLI

Neni 14 – Të drejtat dhe detyrimet

- 14.1 Organi më i lartë drejtues i Shoqërisë "UP GROUP" shpk është asambleja e ortakëve. Të gjitha vendimet e marra nga asambleja e ortakëve regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për Shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të Ekspertëve Kontabël të Regjistruar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
 - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - gj) riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
 - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji.

Neni 15 - Mbledhja e asamblesë së përgjithshme

- 15.1. Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga ligji, dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.



- 15.2. Asambleja e përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- 15.3. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% të aseteve të shoqërisë, që rezulton na pasqyrat financiare të çertifikuara nga eksperti kontabël.
- 15.4. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët.

Neni 16 - Mënyra e thirrjes së asamblesë

- 16.1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë. Njoftimi me shkresë duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- 16.2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 17 - Kërkesa nga ortakët e pakicës

- 17.1 Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të Shoqërisë, mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës.

Neni 18 - Përfaqësimi në asamble

- 18.1. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
- 18.2. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
- 18.3. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 19 - Kuorumi

- 19.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht.



- 19.2 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 20 - Marrja e vendimeve

- 20.1. Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.
- 20.2. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës për çështjet e tjera.
- 20.3. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

Neni 21 - E drejta e votës

- 21.1. Çdo kuotë jep të drejtën e një vote.
- 21.2. Ortakët kanë të drejtën, që u njihet nga ligji apo statuti, për të marrë unanimisht çdo vendim, me kusht që kjo marrëveshje të bëhet me shkrim.

Neni 22 - Përjashtimi nga e drejta e votës

- 22.1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
- 22.2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 23 - Procesverbalet e mbledhjes së asamblesë

- 23.1 Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.
- 23.2. Procesverbali përmban datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.
- 23.3. Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.
- 23.4. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

Neni 24 - Hetimet e posaçme



24.1 Asambleja e përgjithshme mund të vendosë nisjen e një hetimi të posaçëm për parregullsitë përgjatë veprimeve të themelimit të Shoqërisë apo të ushtrimit të veprimtarisë tregtare, ne perputhje me rregullat e percaktuara ne nenin 91 te Ligjit Nr. 9901, date 14/04/2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”.

Neni 25 - Shfuqizimi i vendimeve të parregullta dhe dëmshpërblimi

25.1 Asambleja e përgjithshme ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës përkatëse shfuqizimin e vendimeve të administratorëve, kur këto përbëjnë shkelje të rëndë të ligjit ose të statutit, ne perputhje me rregullat e percaktuara ne nenin 92 te Ligjit Nr. 9901, date 14/04/2008 “Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 26 – Administrimi

26.1. Shoqëria administrohet nga administratorët. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë për një periudhë 5 vjeçare, me të drejtë ripërtëritjeje. Administrator i shoqërisë “UP GROUP” shpk për një periudhë 5-vjeçare, duke filluar nga data e miratimit të këtij statuti, do të jenë z. Dorian BOJA.

26.2. Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

b) përfaqësojnë shoqërinë;

c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë;

ë) kryejnë detyra të tjera të percaktuara në ligj dhe në statut.

26.3. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë, me shumicë të zakonshme.

Neni 27 - Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësia

27.1 Administratorët detyrohen të kryejnë detyrat e tyre të percaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të Shoqërisë në tërësi. Administratorët përgjigjen ndaj Shoqërisë për çdo veprim që vjen në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale.

Kapitulli IV



SHPËRNDARJA E FITIMIT

Neni 28 - Shpërndarja e fitimeve

28.1 Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë. Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.

Kapitulli V

PRISHJA E SHOQËRISË

Neni 29 - Shkaqet e prishjes së shoqërisë

Shoqëria prishet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk kryen veprimtari tregtare për dy vjet ;
- d) me vendim të gjykatës;

Neni 30 - Largimi i ortakut për shkaqe të arsyeshme

30.1 Ortaku mund të largohet apo perjashtohet nga shoqëria në kushtet dhe sipas procedurave të percaktuara në Ligjin Nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 31 - Amendamentet

31.1 Ketij statuti mund t'i behen amendamente sa here që asambleja e shëh të arsyeshme. Për amendamentet asambleja duhet të vendosë sipas percaktimeve që bën ligji.

Ky statut hartohet në 3 kopje në gjuhën shqipe.

ASAMBLEJA E ORTAKËVE

Gerson **TAFA**

Endri **NOTI**

Gerson Tafa

Endri NOTI

Tiranë, më 22.01.2024